



Pranimi / Dorezimi Punisheni / Protokoli Received / Delivery	02.12.2021	1	viti god year
Organ / Shërbimi Organ / Jedinstvo Org / Unit	Dr. Prot. Dr. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHCK	5783/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.869/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.869/2021 të datës 19.10.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Sahide Metushi" nr.28, Shtime, kundër Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, dhe nenin 47 dhe 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.869/2021 e datës 19.10.2021, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.424 i datës 15.10.2021 i Divizionit për Burime Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 19.10.2021 ka pashtuar ankesën me numër të protokollit 5087/2021 të regjistruar me numër A.nr.869/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.424 të datës 15.10.2021 të Divizionit për Burime Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 20.10.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Administratës Tatimore të Kosovës. Këshilli me datë 02.11.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 5246/2021, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5087/2021 të regjistruar me numër A.nr.869/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt Emërimit të datës 01.10.2012 me nëmuri të protokollit 02/523/09; Vendimin me numër të protokollit Nr.424 të datës 15.11.2021; Vendimin Nr.415 të datës 14.10.2021; Ankesën e datës

15.10.2021; Konkursin e datës 28.09.2021; Kërkesën për përgjigje ne ankese te datës 20.12.2021 me nëmuri të protokollit 5105/2021; Përgjigjen ne ankese te date 26.10.2021 me numër të protokollit 441; Aplikacionin e ankuesit Akt Emërimit e datës 01.10.2012 me numër të protokollit 02/523/09 të ankuesit; Diplomën e datës me numër 941/15 të datës 29.07.2015 te ankuesit me te cilën mori titullin Bachelor ne Menaxhment dhe Informatikë; Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në punë 2020 të ankuesit; Formularin e Vlerësimit te rezultateve ne pune 2019 për ankuesin; Vërtetimin e datës 27.09.2021 me numër te protokollit 342; Njoftimin e datës 14.10.2021 me numër të protokollit 417; Njoftimin e datës 22.10.2021 me numër të protokollit 437; Lista e Aplikanteve me numër të referencës RN00007589.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas analizimit te të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji, bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se Administrata Tatimore e Kosovës, me datë 28.09.2021 ka shpallur konkursin me numër Ref.RN00007589 për "Lëvizje brenda kategorisë" për pozitën e punës "Zyrtar për Mbledhje të Detyrueshme" në kuadër të Departamentit Zv.DP- Operacionet.

Organi i punësimit me rastin e shpalljes se konkursit, ka përcaktuar kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, si në vijim: *Të jetë nëpunës civil i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve te fundit të vlerësimit; Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.*

Ndërsa sipas konkursit në fjalë si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: *Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Kualifikime të posaçme formale: Se paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës se lire të punës.*

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi mirëpo Divizioni për Burime Njerëzore në ATK, në fazën e verifikimit të dokumentacionit, ka nxjerr Vendimin me numër 415 të datës 14.10.2021, përmes të cilit ka refuzuar aplikacionin e ankuesit me arsyetimin se i njëjti nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në konkurs për faktin se ankuesi mban pozitën Vozitës.

I pa kënaqur me vendimin e datës 14.10.2021 të Divizionit për Burime Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës, me datë 15.10.2021 ankuesi ka parashtruar ankesë në Divizionin për Burime Njerëzore në ATK, ku kjo e fundit përmes Vendimit Nr.424 e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi, kundër Vendimit Nr.424 të datës 15.10.2021 të Divizionit për Burime Njerëzore të ATK-së, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vendimi i kundërshtuar është i pa bazuar pasi që i njëjti pretendon se ka pozitën e nëpunësit civil dhe si rrjedhojë i ka plotësuar kriteret e konkursit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenit 40 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, fillimisht bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, e cila është procedurë konkurrimi e mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Rregullorja (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka specifikuar kushtet dhe kërkesat e veçanta për lëvizjen brenda kategorisë, përkatësisht



me nenin 41 të kësaj rregullore parashihet se: 1. Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurrimit. 2 Kushtet që duhet ti plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit. 3. Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për konkurim për lëvizjen brenda kategorisë".

Andaj, meqenëse se ankuesi sipas shkresës se emërimit me numër protokolli 02/523/09 të datës 01.10.2012, mban pozitën e punës "Vozitës", Kolegji vlerëson ankuesi ka statusin e Nëpunësit administrativo-teknik - dhe mbështetës siç përcaktohet me nenin 2 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, dhe i njëjti nga ky pozicion nuk mund të aplikojë në një pozitë të Shërbimit Civil të kategorisë profesionale.

Kështu që Njësia për Burime Njerëzore në kuadër të ATK-së, me rastin e nxjerrjes se Vendimit Nr.415 të datës 14.10.2021, lidhur me konstatimin se ankuesi nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në konkursin e shpallur me datë 28.09.2021, për lëvizje në kategori, për pozitën e punës "Zyrtar për Mbledhje të Detyrueshme" si dhe Vendimin Nr.e datës 15.10.2021 për refuzimin e ankesës si të pabazuar, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me nenin 41 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe nenin 45 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në rrethanat si me lartë dhe në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 869/2021

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtës

Jeton KOCA
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore në ATK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;